

E DREJTA PËR INFORMIM


Në vëmendje të Titullarëve të Autoriteteve Publike dhe Koordinatorëve për të Drejtën e Informimit

Ndryshimet ligjore të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, (ILD) përcaktojnë detyrime të reja dhe përgjegjësi dhe sanksione për titullarët e autoriteteve publike:

- Referuar pikës 1, të nenit 10, të ILD-së, Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik i njofton Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit;
- Referuar pikës 3, të nenit 10, të ILD-së, gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit të caktuar si koordinator për të drejtën e informimit për shkelje të dispozitave të këtij ligji, autoriteti publik kërkon mendimin e Komisionerit për çështjen. Në vendimin përfundimtar autoriteti publik arsyeton edhe për pranimin ose refuzimin e mendimit të Komisionerit;
- Referuar shkronjës n, të pikës 2, të nenit 18, të ILD-së, veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:
- Moscaktimi i koordinatorit nga titullari i autoritetit publik ose mosnjoftimi pranë Komisionerit mbi këtë caktim, sipas dispozitave të pikës 1 të nenit 10, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë.

Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit

Vendim Nr. 4 - Presidenti i Republikës



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shkurt 2024.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shkurt 2024, ka dhënë 1 vendim në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Me vendim nr. 04, datë 22.02.2024, Zyra e Komisionerit ka vendosur rrëzimin e ankesës ndaj Autoritetit Publik "Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni dhe konkretisht:

-Kopje të Procesverbalit të Këshillit të Sigurisë datë 21 mars 2008, me objekt: "Analiza e ngjarjes së Gërdecit, masat e marra dhe parandalimi i krizave të tilla në të ardhmen".

Pas konsultimit të legjislatorit të posaçëm, lidhur me kërkesën për informacion, Autoriteti Publik, ka sqaruar se: "..... Në lidhje me pretendimin e refuzimit të dokumentacionit të kërkuar nga Ankuesi, sqarojmë se, kopja e kërkuar e procesverbalit të Këshillit të Sigurisë datë 21 Mars 2008 me objekt, "analiza e ngjarjes së Gërdecit, masat e marra dhe parandalimi i krizave të tilla në të ardhmen", nuk mund të jepet, pasi në bazë të nenit 9 dhe 10 të ligjit nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar", ky procesverbal përbën informacion të klasifikuar "sekret shtetëror" dhe ka nivelin më të lartë të klasifikimit "tepër sekret", afati i ruajtjes së këtij klasifikimi është 35 vjet, e përcaktuar nga autoriteti klasifikues. Ky parashikim gjithashtu vjen në përputhje dhe me LDI, pika 2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, propocionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtem: a) Sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislatori për informacionin e klasifikuar."

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, ka vijuar me ankimin duke pretenduar se: "...Së pari: Në asnjë rast nga ana e autoritetit publik nuk na është vënë në dispozicion dokumenti provues (urdhër, vendim etj) në të cilin percaktohet se dokumenti i kërkuar nga ana jonë është konsideruar si sekret shtetëror "tepër sekret" dhe që afati i klasifikimit të tij është 35 vjet. Sipas nenit 21 të ligjit nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar", informacioni duhet të klasifikohet për periudhën maksimumi 10 vjet, dhe në rast miratimi nga titullari mund të zgjatet edhe 10 vite të tjera por në asnjë rast nuk parashikohet diskrecion i vetë autoriteteit për të përcaktuar afatin e ruajtjes që në rastin konkret është 35 vjet. Së dyti: në asnjë rast autoriteti publik nuk ka zbatuar ligjin për rishikimin e klasifikimit të informacionit që përbën dhe detyrim ligjor. Neni 6 i ligjit Nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar" parashikon: "E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar është i klasifikuar, referuar pikës 5, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Nga ana tjetër, neni 17, pika 5 i ILD parashikon: "5. E drejta e informimit nuk kufizohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara "sekret shtetëror". Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar"

Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuarin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në cdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kriterëve të këtij neni." Referuar dispozitave të sipërcituara, autoriteti publik nuk duhet të refuzojë në mënyrë të menjëhershme dhënien e informacionit por fillimisht duhet të fillojë procedurën e rishikimit të klasifikimit të informacionit dhe më pas le njoftojë në lidhje me procesin e kthimit përgjigjes. Së treti: autoriteti publik refuzon dhënien e informacionit duke u bazuar në nenin 17 të ligjit "Për të drejtën e informimit", pika 2 sipas së cilit parashikohet: E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtem:

b) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislatori për informacionin e klasifikuar.

Në asnjë rast nuk argumentohet se cili është dëmi që vjen nga dhënia e informacionit dhe ku qëndron çënimi i sigurisë kombëtare në këtë rast. Nga ana e autoritetit publik, nuk është bërë asnjë procedurë rishikimi i cili mund të përcaktojë se cilat pjesë të dokumentacionit mund të vihen në dispozicion dhe cilat jo por vijon me refuzimin e plotë të dhenies së informacionit.

Përsa më sipër, duke qenë se autoriteti publik nuk ka përmbushur detyrimin e tij për dhënien e informacionit, kërkojmë pranimin e ankesës dhe detyrimin e autoritetit publik për të vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga ana jonë."

Pas verifikimit të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe parashtrimeve të dhëna nga Autoriteti Publik, Zyra e Komisionerit ftoi palët në një seancë dëgjimore, me prezencën e përfaqësuesve të ankuesit dhe Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët rikonfirmuan qëndrimet e reflektuara në aktet sipërcituar. Ndërkohë, Komisioneri solli në vëmendje të përfaqësuesve të Autoritetit Publik, procedurën që duhet të ndjekë ky i fundit në zbatim të pikës 5 të nenit 17 të LDI. Në vijim, Autoriteti Publik, sqaroi se: "...Komisioni i Deklasifikimit, Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret Shtetëror", zhvilloi procedurën sipas ligjit për informacionin e klasifikuar nr. 10/2023 dhe VKM-në nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror".

Ndërkohë, pas sqarimit të bërë në seancë dëgjimore nga Komisioneri, Autoriteti Publik, ka trajtuar kërkesën sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 17 të LDI.

Konkretisht, bazuar në parashikimet e sipërcituara, Autoriteti Publik ka sqaruar se: "...Komisioni i Deklasifikimit, Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret Shtetëror", me vendim nr. 1, datë 14.2.2024, vendosi përjashtimin nga deklasifikimi të procesverbalit të Këshillit të Sigurisë, datë 21 Mars 2008, me objekt: "Analiza e ngjarjes së Gërdecit, masat e marra dhe parandalimi i krizave të tilla në të ardhmen". Ky informacion mbetet i klasifikuar në nivelin "Tepër sekret", me afat ruajtje 35 vjet."

Per sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se në parim dokumentacioni objekt shqyrtimi përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të LDI, në rastin konkret e drejta për informim kufizohet në përputhje me shkronjën a) të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, rrëzimin e ankesës ndaj Autoritetit Publik "Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Empowering Individuals through Access to Information:

Ensuring Transparency and Inclusivity in an Interconnected World

3 - 5 June, Tirana

Edicioni XV i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) këtë vit do të përqendrojë punimet e tij rreth fuqizimit të individëve përmes ligjeve të aksesit në informacion. Kjo konferencë synon të bashkojë aktorë nga sektorë të ndryshëm për të eksploruar rolin kritik të aksesit në informacion sipas parimeve të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies në një botë të ndërlidhur.

Konferenca do të ketë sesione, sesione paralele, aktivitete paralele, takime të ndryshme dhe të reja nga aktiviteti i punës së ICIC. Diskutimet në panel do të përfshijnë ekspertë nga sektorë të ndryshëm, duke ofruar këndvështrime të ndryshme mbi temat e konferencës. Aktivitetet paralele do të ofrojnë mundësi për eksplorim më të detajuar të çështjeve ose projekteve specifike. Organizata të ndryshme do të kenë mundësinë të prezantojnë iniciativat dhe projektet e tyre me pjesëmarrësit e ICIC.

Në kontekstin e fuqizimit të individëve, konferenca do të trajtojë çështjet rreth garancive të aksesit në informacion për njerëzit në situata vulnerabël, me qëllim rritjen e të drejtës së tyre për të marrë informacion publik. Këto grupe ndeshen me sfida dhe barriera të ndryshme kur flasim për çështje si aksesit në informacion.

Gjithashtu, roli i medias dhe shoqërisë civile do të jetë një ndër temat që do të diskutohet në sesionin e hapur të konferencës.

Në epokën e zhvillimeve të vrullshme teknologjike, kompleksitete gjeopolitike dhe transformime shoqërore, sfida të shumta globale ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën themelore të aksesit në informacion. Një sfidë e rëndësishme qëndron tek ndarja dixhitale, ku pabarazitë në aksesin në internet dhe infrastrukturën teknologjike pengojnë shpërndarjen e drejtë të informacionit, duke kufizuar aftësinë e disa popullsive për të ushtruar të drejtën e tyre për të aksesuar informacionin.

Iniciativat e të dhënave të hapura luajnë një rol kryesor në avancimin e aksesit në informacion duke promovuar transparencën, inovacionin dhe bashkëpunimin në sektorë të ndryshëm. Duke i vënë në dispozicion publikut të dhëna publike, fuqizohen individët, kërkuesit dhe organizatat për të aksesuar, analizuar dhe përdorur informacionin për vendimmarrje të informuar.

Për më shumë informacion lidhur me konferencën mund të konsultoni lidhjen <https://informationcommissioners2024.al/conference-programme/>.



Në muajin shkurt 2024, Zyra e Komisionerit ka marrë dijeni për shpalljen e Vendimit nr. 36, datë 23 janar 2024, të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, i cili ka vendosur ndryshimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rrëzimin e kërkesë-padisë dhe për rrjedhojë ka lënë në fuqi vendimmarrjen e Komisionerit.

Konkretisht, me anë të vendimit nr. 54, datë 07.12.2021, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Autoriteti Publik, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ku kërkohet informacion mbi: Emrin dhe kopjen e kontratës së nënshkruar me kompaninë/sipërmarrjen private që ka kryer mbështetje financiare të Autoritetit Publik, për të përballuar koston financiare të shpenzuar në kuadër të një aktiviteti.

Autoriteti publik pasi kishte shqyrtuar kërkesën informoi kërkuesin se "Një pjesë e informacioneve të diskutuara në aktivitet janë konfidenciale, po ashtu organizimi dhe zhvillimi i këtij aktiviteti përmban klauzola kontraktuale, që e kufizojnë aksesin e palëve të treta jashtë këtij aktiviteti".

Kërkuesi i informacionit me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit. Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", (në vijim LDI). Nga shqyrtimi i çështjes, Komisioneri konstatoi se AP nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, të përcaktuara në këtë marrëveshje, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Autoriteti Publik, në kundërshtim me LDI, ka anonimizuar edhe të dhënat e shoqërive tregtare të cilat nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe përpunimi i të dhënave të tyre nuk kufizohet nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Në këto kushte, nga Autoriteti Publik duhet të rivlerësohet dokumentacioni dhe vetëm nëse marrëveshja përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk janë përfaqësues të shoqërive tregtare, përhapja e të cilave mund të çënojë privatësinë, në këtë rast, këto të dhëna duhet të anonimizohen.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie të informacionit të kërkuar, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". uke mos qenë dakord me sa më sipër, Autoriteti Publik e ka bërë çështjen konflikt gjyqësor, ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, duke kërkuar prishjen e Vendimit Nr. 54, datë 07.12.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

kërkuesi nëpërmjet kërkesës datë 26.10.2021, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me: "Kopje e kontratës së nënshkruar me kompaninë/sipërmarrjen private që ka kryer mbështetje financiare të AP, për të përballuar koston financiare të shpenzuar në kuadër të aktivitetit".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë.

Gjykata e Shkallës së parë ka konsideruar interes publik, respektimin e klauzolave kontraktore të konfidencialitetit, pavarësisht se ligjvënësi, pikërisht interesin publik rezulton ta ketë parashikuar si përjashtim nga e drejta për ta përkuftizuar informacion, pra si një shkak që i përmbys te gjitha kufizimet ligjore të drejtës së informimit, në të cilat liria kontraktore nuk zë vend.

Për sa i përket vlerësimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, ky përfundim do të mund të kishte qenë i pranueshëm logjikisht dhe ligjërish, vetëm nëse pala paditëse, gjatë gjykimit në shkallë të parë do të kishte dokumentuar faktin se, pikërisht sponsori i aktivitetit të organizuar prej saj në një hotel në jug të vendit, ishte autor sui generis i formulës së suksesit të veprimtarisë së mëtejshme të AP-së dhe i strategjisë në funksion të arritjes së këtij objekti madhor e që për këtë shkak, do të mund të gëzonte mbrojtje si subjekt i parashikuar në Nenin 17/1,c të ligjit nr. 119/2014, në lidhje me Nenin 21 të ligjit nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, sipas përmbajtjes së të cilit: “1. Autori ka të drejtë të vendosë për kohën dhe vendin, si dhe për mënyrën me të cilën dëshiron t’ia bëjë të njohur për herë të parë veprën publikut. 2. Përpara bërjes publike të veprës, çdo informacion për përmbajtjen e tij mund t’i jepet publikut vetëm me pëlqimin e autorit.”

Autoriteti me klauzola kontraktore konfidenciale, kupton sekretin tregtar, në kuptim që mosrespektimi i këtyre klauzolave që ndalojnë bërjen publike të emrit të sponsorizuesit, përbën nxjerrje sekreti tregtar, Gjykata e Apelit Administrativ vlerëson të qenurit e tij të pabazuar, për faktin e thjeshtë se, ndryshe nga emri i personit juridik që nuk përbën kurrfarë sekreti, sekreti tregtar ka të bëjë me punën, me detyra të caktuara dhe me veprimtari të posaçme tregtare, të cilat nuk duhet të shpallen a te njihen botërisht.

Gjykata e Apelit Administrativ, në mungesë të rrethanave të klasifikuara me ligj si sekret tregtar, ekzistenca e të cilave do të përligjte dhënien e pjeshme nga autoriteti, të informacionit të kërkuar (edhe pse, ky shkak, sikurse sqaruam me lart, nuk rezultoi t’i ishte bërë me dije qartësisht, as kërkuesit/personit të tretë, as të paditurit/Komisionerit, por u konstatua të ishte artikuluar për herë të parë, vetëm në padi), vlerëson të qenurit të pabazuar të pretendimit se, informacioni lidhur me emrin e sponsorizuesit, mbrohej nga një kufizim i të drejtës së informimit.


Gjykata e Apelit Administrativ mbërrin në këtë përfundim dhe në raport me pretendimin e bazuar në nenin 4/7 të ligjit nr.84/2016, përse kohë nuk rezulton të jetë argumentuar se, informacioni lidhur me emrin e sponsorizuesit, do të shkaktonte dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Gjykata e Apelit Administrativ e vlerëson tejet korrekt argumentin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasqyruar në Vendim nr. 54 dt.07.10.2021, se:


“...informacioni i kërkuar në kërkesat përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr.11/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe kufizimet e pasqyruara në marrëveshje nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet ta vendosi atë në dispozicion të kërkuesit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Theksojmë se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve”.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



idp.albania



IDP Albania



Komisioneri KDIMDP